Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Nr/Br. 1087/20
Date/Datum 26.01.21
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH.nr.1087/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068,dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, z. Blerim Dina – Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik D.P.H "LUZERN" – Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik OE "JETMIRI" SH.P.K-Gllogoc, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Shërbime hoteliere me pije Lot.1", me numër të prokurimit: 214-20-1607-2-1-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues– "Ministria e Punëve të Brendshme"/MPB/, më datë: 25.01.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET**, pjesërisht si e pa bazuar ankesa e operatorit ekonomik D.P.H "LUZERN" – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Shërbime hoteliere me pije Lot.1", me numër të prokurimit: 214-20-1607-2-1-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues– "Ministria e Punëve të Brendshme"/MPB/.

II. **VËRTETOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit, me titull "Shërbime hoteliere me pije Lot.1", me numër të prokurimit: 214-20-1607-2-1-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues - "Ministria e Punëve të Brendshme"/MPB/.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik D.P.H "LUZERN" – Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues D.P.H "LUZERN" - Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 11.12.2020 me nr 1087/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Shërbime hoteliere me pije Lot.1", me numër të prokurimit 214-20-1607-2-1-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues - "Ministria e Punëve të Brendshme" /MPB/, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 27, 28, 51, 52, 56, 59, 60, 64 dhe 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 15.12.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues te prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 31.12.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në pretendimin nr.1

Pretendimi kryesorë ankimorë sipas ankesës nr.1087/20 është se i njëjti eshte ne përputheshmëri të plotë me nenin 27 dhe 28 të ligjit të prokurimit publik të Republikës së Kosovës dhe plotësisht e përmbushur me rregullat specifike teknike të kritereve në dosjen e tenderit me titull "shërbime hoteliere me pije per lot.1".

Sqarojmë se me vendimin e fundit të OSHP-së lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, vendimi nr.537/20, paneli shqyrtues me rastin e kthimit të lëndës në rivlerësim e ka obliguar AK-në që të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së për të vërtetuar se të njëjtit a plotësojnë kërkesën nga neni 9.1 dhe 9.2.

Sipas vendimit për rishqyrtim, AK konform vendimit të OSHP-së nr.537/20 ka kërkuar sqarime shtesë nga OE, ku pas pranimit të sqarimeve kanë vlerësuar se:

"...tenderuesi ankues, D.P.H. „Luzern" edhe për kundër kërkesës nga autoriteti kontraktues për sqarimin e tenderit është eliminuar sepse tenderi i tij i dorëzuar është i papërgjegjshëm sepse nuk ka dorëzuar dëshmi të vlefshme dhe të mjaftueshme te kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale...".

Bazuar në rivlerësimin e AK-së dhe vendimin e kërkesës për rishqyrtim, vlerësojmë se AK kanë vepruar në pajtim me obligimet e cekura në vendim të OSHP-së nr.537/20.

OE ankues përmes ankesës nr.1087/20 po ashtu pretendon se :

"...njoftimin për kontratë si dhe në dosjen e tenderit e shohim qartë se për tenderin me titull "sherbimet hoteliere per lot 1" është kërkuar shërbime vetëm për pije e kurrsesi me ushqim. Sqarojmë se pas analizimit të dosjes së tenderit, tek specifikimet teknike tek Lot 1, pas pjesës "A" e cila mban 7 pozicione për pije është edhe pjesa "B" (e përshkruar më larte në këtë raport) cila mban 33 pozicione për ushqime të ndryshme, dhe tek pjesa B, autoriteti kontraktues ka shënuar se:

"Gjësendet e mëposhtme mund të porositën nga MPB-ja, në rast të eventeve të ndryshme, Pesha e nën totalit 5%".

Bazuar në gjitha këto që u cekën më lartë vlerësojmë se pretendimet ankimore të OE ankues janë të pabazuara.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues **të refuzohet e pabazuar, ndërsa të vërtetohet vendimi i AK-së për dhënie të kontratës.**

Autoriteti Kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës 05.01.2021 ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik përmes parashtresës me shkrim të datës 06.01.2021 ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues. Të caktohet seancë për vendimin përfundimtar të kësaj lënde.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 21.01.2021, nëpërmjet platformës elektronike ZOOM, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli Shqyrtues sqaron se pretendimi i OE ankues sipas ankesës nr.1087/20 është se i njëjti është në përputhshmëri me nenin 27 dhe 28 të ligjit për prokurimin publik të Republikës së Kosovës dhe e përmbushur me rregullat specifike teknike të kritereve në dosjen e tenderit me titull "shërbime hoteliere me pije per lot.1". Paneli Shqyrtues sqaron se në vendimin paraprak të OSHP-së për këtë aktivitet të prokurimit PSH.nr.537/20 e ka kthyer lëndën në rivlerësim duke e obliguar AK-në që të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së për të vërtetuar se të njëjtit a plotësojnë kërkesën nga neni 9.1 dhe 9.2. AK konform vendimit të OSHP-së PSH.nr.537/20 ka kërkuar sqarime shtesë nga OE, ku pas pranimit të sqarimeve kanë vlerësuar se "...tenderuesi ankues D.P.H. "Luzern" edhe për kundër kërkesës

nga autoriteti kontraktues për sqarimin e tenderit është eliminuar sepse tenderi i tij i dorëzuar është i papërgjegjshëm sepse nuk ka dorëzuar dëshmi të vlefshme dhe të mjaftueshme te kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale...". Bazuar në rivlerësimin e AK-së dhe vendimin e kërkesës për rishqyrtim, vlerësojmë se AK kanë vepruar në pajtim me obligimet e cekura në vendim të OSHP-së nr.537/20.

OE ankues përmes ankesës nr.1087/20 po ashtu pretendon se "...njoftimin për kontratë si dhe në dosjen e tenderit e shohim qartë se për tenderin me titull "sherbimet hoteliere per lot 1" është kërkuar shërbime vetëm për pije e kurrsesi me ushqim. Sqarojmë se pas analizimit të dosjes së tenderit, tek specifikimet teknike tek Lot 1, pas pjesës "A" e cila mban 7 pozicione për pije është edhe pjesa "B" (e përshkruar më larte në këtë raport) cila mban 33 pozicione për ushqime të ndryshme, dhe tek pjesa B, autoriteti kontraktues ka shënuar "Gjësendet e mëposhtme mund të porositën nga MPB-ja, në rast të eventeve të ndryshme, Pesha e nën totalit 5%". Andaj, Paneli Shqyrtues konsideron se AK ka vepruar konform dispozitave ligjore me rastin e vlerësimi të këtij aktiviteti të prokurimit.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve dhe analizës konkrete, sqaron se autoriteti kontraktues me rastin e rivlerësimit të ofertave ka kërkuar sqarime shtesë konform vendimit të Panelit Shqyrtues PSH.nr.537/20, ku pas sqarime ka bërë vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderëve sipas kërkesave të dosjes së tenderit dhe në harmoni me nenin 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Nuhi PAÇARIZI

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK "MPB";

1x1 OE "DPH LUZERN"-Prishtinë;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.